




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 12075/3 Prot.

Tiranë, më 10/11/2015

Drejtuar: MINISTRISË SË KULTURËS
Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu", Ish-Kinostudio, Tiranë

Subjekti: Lidhur me një urdhër të përbashkët

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.4179, datë 21.08.2015 ku është paraqitur për mendim dhe firmosje projekt-urdhri i përbashkët i ministrit të Kulturës dhe ministrit të Financave "Për miratimin e tarifave që realizohen nga të ardhurat e veprimtarisë ekonomike të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik", shprehemi:

- Në zbatim të gërmës b) të pikës 1, të VKM-së nr. 432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore", ku janë përfshirë të ardhurat e realizuara nga aplikimi i këtyre tarifave, miratimi i tyre bëhet nga ministri i Financave, sipas propozimit të ministrisë përkatëse.
- Për sa më sipër, Ju miratojmë tarifat për shërbimet që kryhen nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik", si më poshtë:
 - Tarifë vëzhgimi 1.68 lekë/1 m² vëzhgim
 - Tarifë gërmimi/sondazhi 67.152/1m³ gërmim
- Të ardhurat e realizuara nga aplikimi i këtyre tarifave do të përdoren 30% për llogari të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, sipas limitit të përcaktuar në planin e buxhetit dhe 70%, derdhen në buxhetin e Shtetit.
- Të ardhurat e realizuara nga aplikimi i këtyre tarifave, duhet të përfshihen në udhëzimin e përbashkët nr. 52, datë 9.02.2015 "Për krijimin e administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës", gjë që kërkon ndryshimin përkatës të tij.

Me respekt,

